

Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Edukimit
(Syllabus)

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit / Fillor
Titulli i lëndës:	Metodologjia e Shkencave Shoqërore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	3 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Minevere Morina Rashiti, prof.ass.
Detajet kontaktuese:	minevere.rashiti@uni-pr.edu
	minevererashiti@yahoo.com
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Metodologjia e shkencave shoqërore, si lëndë studimi, përbëjnë integralen e shkencave shoqërore, bazamentin e vështrimit sociologjik dhe shumëdimensional të shoqërisë. Kategorinë e shkencave shoqërore e paraqesin disiplinat akademike-shkencore të cilat merren me studimin e jetës shoqërore të grupeve njerëzore dhe të individit. Kjo kategori shkencash sintetike përfshin materjen nga predimensionaliteti i përgjithshëm sociologjik dhe antropologjik, filozofik, politikologjik, historik, gjeografik, edukologjik, demografik, juridik, psikologjik, linguistik.</p> <p>”Shkencat shoqërore” si termin unifikues dhe mbulesë i referohet fushave jashtë shkencave natyrore. Domethënia mund të përdoret në kontekst specifik të reflektimit në shkencën shoqërore origjinale të krijuar në shekullin XIX si sociologji. Emile Durkheim, Max Weber citohen të jenë arkitektë tipik modern të shkencës shoqërore apo shkencave shoqërore.</p> <p>Kursi ka për qëllim të prezantojë zhvillimin e shkencave shoqërore nga shkencat eksperimentale dhe aplikative dhe dijeve të mbështetura në praktikë. Kursi pikësynon të paraqes lindjen e hulumtimit shoqëror, studimin e fakteve sociale, hapjen e ideve meta-teorike dhe të teorive individuale.</p>

Qëllimet e lëndës:	<p>Kursi ofron të kuptuarit dhe interpretuarit e kategorisë së shoqërisë dhe të kategorive të tjera shoqërore. Shtron rrafshet e të kuptuarit të brendisë së shoqërisë përmes shpjegimit të fenomeneve sociale, antropologjike, filozofike, psikologjike, historike, gjeografike për të depërtuar në kuptimet e socializimit: socialitetit, socio-abilitetit dhe socio-gjenitetit të njeriut dhe shoqërisë.</p> <p>Kursi u ofron studentëve të kuptuarit e ligjeve dhe ligjësive të shoqërisë, formimin e mendimit kritik e praktik në të njohurit e fenomeneve shoqërore, të interpretuarit dhe aplikuarit në dimensionet e jetës njerëzore dhe për t'a përvetësuar metodologjinë e hulumtimit shkencor në shkencat shoqërore.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Përmes kombinatorikës metodologjike të frymës së filozofisë së re të shpjegimit dhe të nxënies-studimit: prezantim – pjesëmarrje aktive e studentëve, do të realizohet kuantitativ dhe praktikë i substancës studimore të shkencave shoqërore me metodologji. Studentët do të aftësohen për të kuptuar nocionet themelore të fenomeneve shoqërore përmes shpjegimit, prezantimit, referimit, analizimit, hulumtimit të përmbajtjeve, teksteve, komenteve, seminareve, thurjes së teksteve praktike dhe teoretizimeve të përmbajtjeve të ndryshme nga fusha e shkencave shoqërore për të krijuar kuptimin e drejtë mbi shoqërinë dhe fenomenologjinë e saj-ligjet e strukturimit dhe dinamizimit të shoqërisë në kohë dhe hapësirë të caktuar.</p>

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15/javë	45
Ushtrime teorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Ushtrime në teren	3	1	3
Kollokfiume, seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	1	13	13

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	6	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezentimet, etj	2	5	10
Totali	25	/	168

Metodologjia e mësimdhënies:

Ligjerata interaktive, pune interaktive grupore e individuale, ese, prezantime të ndryshme, punime seminarike, punë hulumtuese në tema të ndryshme të lidhura praktikisht me çështje shoqërore. Realizimi përmes kombinatorikës së metodave hulumtuese të përgjithshme dhe operacioneve logjike: induksioni, deduksioni, analiza sinteza e forma të tjera.

Metodat e vlerësimit:

Provimi mbahet me test dhe me gojë:

- Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim: 10%
- Puna praktike dhe seminarët 20 %
- Testet intermediere (semestrare dhe gjysmësemestrare) (2) 30%
- Provimi 40%
- Totali 100%

Literatura

Literatura bazë:

A.Giddens, Sociologjia, Prishtine,2002
A.Dida, Fillet e sociologjisë, Prishtinë, 1998.
Ante Fiamengo, Bazat e sociologjisë së përgjithshme, Prishtinë,1984.
Raino Malnes, Filozofia politike, Prishtinë, 2007.
S.Stumpf, Filozofia, Prishtine, 2004.
Platoni, Shteti, Prishtinë, 1994.
Aristoteli, Politika, Prishtinë,1998.
M. Rashiti, Bazat e Shkencave Shoqërore me Metodologji, Prishtinë, 2014
R.Supek, Ndryshimet kulturore dhe ideologjike në shek.xx, Zagreb, 1960.
Michael Hill, Sociology of Public Administration,

	New York, 1998.
Literatura shtesë:	<p>J. Gerring, D. Christenson, Applied Social Science Methodology: An Introductory Guide, 2017.</p> <p>J. Gerring, Social Science Methodology: A Unified Framework, 2001.</p> <p>A. Bryman, Social Research Methods, Oxford University Press, 2012.</p> <p>D. Apgar, Social Work ASWB Bachelors Exam Guide, 2018</p> <p>P.G. Fitchett, J. Passe, The Status of Social Studies: Views from the Field, Towson University, 2013.</p> <p>J. Thornton, Teaching Social Studies that Matters: Curriculum for Active Learning, Teachers College Press, 2005</p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Problemet shoqërore dhe shoqëria bashkëkohore
<i>Java e dytë:</i>	Shkencat natyrore dhe shoqërore. Procesi i diferencimit të shkencave; Shkencat shoqërore. Historia e shkencave shoqërore dhe historia e sociologjisë.
<i>Java e tretë:</i>	Disiplinat e shkencave shoqërore. Antropologjia, llojet e antropologjisë. Ekonomia si pjesë integrale e shkencave shoqërore. Historia si shkencë shoqërore. Drejtësia si shkencë shoqërore
<i>Java e katërt:</i>	Gjeografia si shkencë shoqërore. Edukologjia si disiplinë shoqërore. Psikologjia si shkencë shoqërore. Filozofia si shkencë shoqërore.
<i>Java e pestë</i>	Sociologjia si shkencë shoqërore universale. Teoritë sociale dhe metodat e hulumtimit. Veçoritë e diferencimit të shkencave. Dallimet ndërmjet shkencave natyrore dhe shoqërore
<i>Java e gjashtë:</i>	Marrëdhëniet ndërmjet shkencave shoqërore; historia-sociologjia, sociologjia-psikologjia, sociologjia-filozofia, sociologjia-etnografia-etnologjia. Definicioni i sociologjisë dhe shkencave shoqërore.
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësimi 1
<i>Java e tetë:</i>	Sociologjia e përgjithshme dhe sociologjitë e veçanta. Drejtimet themelore sociologjike-shoqërore.

	Mendimet e ndryshme mbi fenomenet shoqërore në antike, në shekullin e mesëm dhe në shekullin e ri
Java e nëntë:	Konceptet themelore në shkencat shoqërore. Baza e shoqërive njerëzore dhe llojet e shoqërive. Kushtet materiale zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Koncepti i strukturës dhe dinamikës së shoqërisë
Java e dhjetë:	Koncepti i mbistrukturës shoqërore. Religjioni si fenomen shoqëror dhe kulturor. Kultura
Java e njëmbëdhjetë:	Vlerësimi 2
Java e dymbëdhjetë:	Koncepti i grupeve shoqërore dhe llojet e tyre. Grupet shoqërore globale dhe grupet parciais. Familja dhe tipet e saj.
Java e trembëdhjetë:	Metodologjia. Metodat e hulumtimit në shkencat shoqërore; metoda e të vërejturit, eksperimenti, metoda statistike, metoda e testit dhe interviste. Metoda historike në shkencat shoqërore. Metoda komparative. .
Java e katërbëdhjetë:	Metodat logjike në hulumtimet shoqërore dhe në shkencat shoqërore Literatura: A.Giddens, Sociologjia, Prishtinë, 2012, M.Rashiti, Shkencat shoqërore me metodologji, Prishtinë, 2011.
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezentimi i punimeve individuale dhe grupore.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<ul style="list-style-type: none"> - Studentët duhet të ndjekin me rregull ligjëratat sipas orarit të lëndës në fjalë; - Mirësjellja gjatë organizimit të mësimit është faktor me rëndësi që reflekton punën në aspektin pozitiv dhe angazhimin në tërësi; - Nuk lejohen telefonat celularë; - Secili studentë ka të drejtë të bëjë pyetje e komente sa herë që i jepet fjala; - Studentët janë të obliguar të respektojnë kolegët gjatë punës grupore dhe diskutimeve në grup; - Nuk lejohet prishja e qetësisë kur ligjërohet nga mësuesi apo prezentohet puna e studentëve; 	

- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo dalja pa ndonjë arsye të qëndrueshme
- Dënohet çdo formë e kopjimit apo falsifikimit.